


Ardhja në Norvegji

Coming to Norway



 Aamiina  Julie Cornelia van Walsum  Maria Hila || 5  Shqip  / English 



LIDA Stories


lidastories.net

Ardhja në Norvegji / Coming to Norway

 Aamiina  Julie Cornelia van Walsum  Maria Hila (sq)




This work is licensed under a Creative Commons [Attribution 4.0 International License](https://creativecommons.org/licenses/by/4.0).
<https://creativecommons.org/licenses/by/4.0>



Unë dhe dy vëllezërit e mi erdhëm në Norvegji në dhjetor të vitit 2016. Ne veshëm rroba vere pasi menduam se në Norvegji do të ishte po aq ngrohtë sa në Somali. Megjithatë, kur arritëm në aeroport, po binte borë. Ne kishim ftohtë dhe moti ishte i freskët. Edhe pse kishim marrë disa valixhe, në to kishte vetëm rroba vere.

. . .


My two brothers and I came to Norway in December 2016. We wore summer clothes because we thought it would be as warm in Norway as it was in Somalia. However, when we arrived at the airport, it was snowing. We were cold and the weather was chilly. Although we had brought a few suitcases, they only had summer clothes in them.



Edhe pse ishte ftohtë, unë isha shumë e lumtur
kur erdhëm në Norvegji. Më në fund do të
takoja përsëri nënën time që nuk e kisha takuar
prej gjash të vitesh. Nëna ime me dy prej
mikeshave të saj na takuan. Kur e pamë, po
qanim prej gëzimit. Udhëtuan për në qytetin e
vogël ku jeton nëna.

...


Even though it was cold, I was very happy when
we came to Norway. I would finally meet my
mum again, whom I had not seen for six years.
My mum and two of her friends met us. When
we saw her, we wept with joy. We drove to the
small town where Mum lives.



Ditët e para në qytetin e nënës ishin shumë të çuditshme. Ishte ftohtë dhe binte borë dhe nuk kishte shumë gjëra për të parë. Rrugët ishin komplet bosh. Ata pak njerëz që takova dukeshin të ftohtë dhe jo miqësorë. Në Somali kishte njerëz kudo, kështu që çdo gjë dukej e huaj këtu. Nëna ime dhe mikeshat e saj na dhanë disa dhurata, dhe më pas ajo na shoqëroi që të blinim rroba dimri.

...

The first days in Mum's town were very strange. It was cold and snowy and there was not much to see. The streets were completely empty. The few people I met seemed cold and unfriendly. In Somalia there were people everywhere, so everything felt unfamiliar here. My mum and her friends gave us some presents, and then she took us to buy winter clothes.



Po të kisha ndenjur në Somali, mendoj se tani do të isha bërë nënë. Ndoshta do të kisha shumë fëmijë. Po të isha në Somali, nuk do të kisha pasur të njëjtat mundësi që kam pasur tani. Ndihem me fat që jetoj në Norvegji.

...

If I had stayed in Somalia, I think I would have been a mother by now. Perhaps I would already have many children. If I had been in Somalia, I would not have had the same opportunities as I have had now. I feel lucky to live in Norway.

Vitin tjetër do të nis shkollën e mesme në degën e shëndetit dhe zhvillimit të të rinjve. Në të ardhmen dua të punoj me të rinjtë. Kur të kem përfunduar arsimin, endrra ime është të gjej një punë të përhershme. Gjithashtu dua të mësoj si të drejtoj makinën dhe të marr patentën.


...

Next year I will start secondary school in the health and youth development section. In the future I want to become a youth worker. When I have finished my education, my dream is to get a permanent job. I also want to learn how to drive and get my driver's licence.

Pas pushimeve të Krishtlindjeve u regjistrova në një kurs për norvegjisht në qendrën e edukimit për të rritur. Studiova aty për dy vite para se të filloja në një shkollë të zakonshme. Tani jam në vitin e fundit, dhe kam zënë shumë miq të rinj. Jam shumë e shqërueshme dhe më pëlqen të takoj njerëz të tjerë.

...


After the Christmas holidays I joined a Norwegian course at the adult education centre. I studied there for two years before starting in an ordinary school. Now I am in my final year, and I have made many new friends. I am very sociable and enjoy meeting other people.



Pas shkollës shkoj në një qendër vullnetare ku më ndihmojnë me detyrat. Jam bërë gjithashtu pjesë e një kursi rrobaqepsie në qendër.

...

After school I go to a centre run by volunteers where I get help with my homework. I have also joined a sewing course at the centre.



Në Somali nuk kisha shkuar kurrë në shkollë ose në ndonjë kurs përveç shkollës së Kuranit. Nuk dija të lexoja apo të shkruaja. Tani kam mësuar të shkruaj në gjuhën somaleze edhe norvegjeze, dhe shumë lëndë të tjera. Pa arsim ndihesha askushi. Tani ndihem e ditur dhe e lumtur.

...

In Somalia I never went to school or did any courses except Quran school. I did not know how to read or write. Now I have learned how to write in both Somali and Norwegian, and many other subjects. Without education I felt I was nobody. Now I feel knowledgeable and happy.